



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.



SPECIFIKIMET TEKNIKE

TE PERGJITHSHME

Liqeni i Bovillës gjendet rreth 15 km në verilindje të qytetit të Tiranës. Ai u formua rreth 15 vjet më parë në pjesën e sipërme të lumit të Tërkuzës, të vendosur midis dy vargmaleve, Krujë - Dajt dhe Skënderbe - Mali me Gropa, hapësirë e shtrirë në zonat e Krujës dhe Tiranës.

Liqeni kufizohet në perëndim me malin e Gamtit (1.267 m) dhe Brarit (1.214 m) si dhe nga mali i Dajtit (1.613) në juglindje. Nga ana lindore kufizohet me malet e Xibrit (1.531 m) dhe të Kotit (1.391 m) të vendosur në veriperëndim midis malit të Skënderbeut dhe në juglindje të malit me Gropa.

Ujëmbledhësi është formuar nga prerja e lumit Tërkuza me një digë 81 m të lartë, në grykën e Zall Herit. Prej vitit 1998, ujëmbledhësi i Bovillës është furnizuesi kryesor me rreth 50% të gjithë konsumit të ujit të pijshëm për qytetin e Tiranës dhe gjithë zonën e banuar për rreth.



Relievi është kodrinor - malor, ku erozioni dhe rrëshqitja janë tepër aktive. Sipërfaqja e liqenit është 4.6 km dhe ka thellësi 18-53 m. Bimësia në pellgun e Bovillës përfshin katër zona fitoklimatike: Zona e pyjeve dhe shkurreve mesdhetare (300 – 600 m), Zona e dushqeve (600 – 1000 m), Zona e ahut (1.000 – 1.600 m) dhe Zona e kullotave malore (mbi 1.500 m).

Zona përreth Bovillës ka një bukuri mahnitëse me ujëvarën e Bovillës, grykën e Bovillës dhe shkëmbinjtë përreth. Shumë agjenci dhe operatorë turistikë e shfrytëzojnë këtë reliev për kacavjerrje dhe ngjitje në shkëmbinj. Në itineraret e tyre marrin pjesë përveç të rinjve edhe mjaft turistë të apasionuar pas natyrës dhe aventurës. Itineraret variojnë në gradë vështirësie, nga të thjeshtat tek ato më të vështirat, për t'u dhënë mundësi të gjithëve në ngjitje dhe kacavjerrje.

Liçeni i Bovillës



Pamje e liçenit

Grupi	41° 26' 38.4" N, 19° 53' 9.6" E
Koordinatat	 41°26'38.4"N 19°53'9.6"E Coordinates:  41°26'38.4"N 19°53'9.6"E
Lloji	Liçen
Shtetet e <u>pellgut</u>	Shqipëria
Ndërtuar më	1988 – 1996

Liçeni i Bovillës ose **Ujëmbledhësi i Bovillës** është një rezervuar 4.6 km² në [Shqipëri](#), përafërsisht 9 miles (14 km) në verilindje të [Tiranës](#) dhe në juglindje të [Krujës](#), në [Parkun Kombëtar të Dajtit](#). Ai siguron shumicën e ujit të pijshëm për Tiranën.

Rezervuari është formuar nga një digë e lumit [Tërkuze](#), një degë e lumit [Ishëm](#). Tërkuza ka burimin e saj në lindje të zinxhirit të jashtëm të vargmaleve bregdetare, që kalon përmes kanionit të thellë të Shkallës së Bovillës ndërmjet malit Maja e Gomtitit (1268 m) dhe malit të Bjeshit (1239 m). Diga qëndron në hyrje të këtij kanioni dhe është bërë nga konglomerati, zhavorri dhe rëra lokale. Është 91 metra e lartë dhe 130 metra e gjatë.

PËRSHKRIMI

Referuar objektit konkret të prokurimit, si dhe vendit ku do të kryhet shërbimi, me qëllim kryerjen e një shërbimi sa më cilësor, duke ruajtur të gjitha parametrat mjedisore dhe në veçanti mjedisin, si dhe sipas qëllimit të objektit, kërkohet makineria, sipas specifikimeve teknike, si më poshtë sqaruar:

- Makineri korrëse/prerëse për barëra të këqija, pastrimi për sipërfaqe nga mbetjet plastike, të ngurta, kanaçe, shkopinj, etj, në liqene, sipas specifikimeve teknike të mëposhtme:

Të jetë me zinxhir për transportin mbetjeve, kjo me qëllim për mbledhjen dhe lëvizjen me transportier të të gjitha mbeturinave të grumbulluara si barëra të këqija, kallamishte, kanaçe, mbetje plastike, shkopinj, etj.

Thellësia e korrjes të jetë të paktën 0.8-1 m.

Të jetë e manovrueshme gjatë punës për pastrimin në liqene.

Zona e korrjes të jetë të paktën 2000-3000 m²/h.

Makineria duhet të jetë e fortë dhe e qëndrueshme.

Shpejtësia e punës të jetë jo më pak se 3 km/h.

Makineria duhet të kryejë grumbullimin, rikuperimin, filtrimin e ujit, transportimin dhe shkarkimin. Të ketë krahë anësore për mbledhjen e mbeturinave, kanaçe, plastike, të drunjta, etj.

Lartësia e shkarkimit të mbeturinave të jetë 0-3.5 m.

Të kryejë procesin e transportimit të mbeturinave të grumbulluara nëpërmjet transportierit.

Depozitimi i mbetjeve të barërave të këqija (mbeturinave, etj) të jetë 8-12 m³.

Makineria duhet të jetë miqësore me mjedisin, si dhe të ketë si fushë zbatimi pastrimin e liqeneve.

Makineria duhet të jetë e pajisur me pjesën e transmisionit të mbledhjes së mbeturinave.

KËRKESAT E SPECIFIKIMEVE

Kontraktori duhet të përmbushë të gjitha kërkesat dhe detyrimet e të gjitha klauzolave të specifikimeve të aplikuara për punët e shërbimit që janë përfshirë në Kontratë. Klauzolat për punimet që nuk përfshihen në këtë Kontratë nuk do të aplikohen. As klauzolat e këtyre specifikimeve, as përshkrimi i detajuar dhe as sasitë e dhëna nuk kufizojnë detyrimet e Kontraktorit nën kushtet e kësaj Kontrate.

Atje ku zerat nuk janë përfshirë në Preventiv për ndonjë kërkesë të tillë apo detyrim, kosto e këtyre kërkesave dhe detyrimeve do të parashikohen të përfshihen në zerat e Preventivit. Sasitë e dhëna në Preventiv vetëm janë vlerësuar dhe ato mund të ndryshojnë gjatë zbatimit të punimeve. Pagesa për këto zera do të bëhet në bazë të punës aktuale të kryer gjatë shërbimit dhe sipas metodës së matjeve dhe pagesës të përshkruar në klauzolat e kontratës së sipërmarrjes së punimeve. Zëvendësimi i materjaleve të specifikuar në Dokumentin e Kontratës, do të bëhen vetëm me aprovimin e Mbikqyrësit/grupit të punës të Punimeve nëse materialet e propozuar për tu zëvendësuar është e njëjta ose më e mirë se materialet e specifikuar; ose nëse materialet e specifikuar nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontrates për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrësit. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë, në formën e kuotimit të certifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materjaleve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

HYRJET NE OBJEKT PËR TË PUNUAR

Të gjitha punimet e nevojshme për të hyrë në objekt do të bëhen nga Kontraktori me shpenzimet e tij. Punëdhënësi nuk ka asnjë përgjegjësi për kushtet apo mirëmbajtjen e ndonjë rruge ekzistuese apo strukture që mund të përdoret nga Kontraktori për kryerjen e punimeve nën këtë kontratë dhe për udhëtimet në dhe nga objekti. Asnjë pagesë nuk do të bëhet tek Kontraktori për ndërtimin, përmirësimin, riparimin apo mirëmbajtjen e ndonjë rruge ekzistuese që mund të përdoret nga Kontraktori për kryerjen e punimeve nën këtë kontratë përveç rasteve që jepen në Preventiv.

Kontraktori do të përgatitë me shpenzimet e tij çdo lehtësi për hyrjet e përkohshme në objekt (rruge, etj) që mund të kërkohen për qëllime ndërtimi nga Inxhinieri. Lehtësi të tilla do të jenë për zgjerimin dhe qëndrueshmërinë e duhur për të lejuar levizjen e të gjitha makinerive dhe pajisjeve si dhe mirëmbajtjen nga Kontraktori në kushte të mira dhe të shërbyeshme gjatë periudhës së shërbimit. Punëdhënësi dhe Inxhinieri si dhe punonjësit e tyre se apo/dhe ata të Kontraktoreve të tjerë që do të punojnë në objekt, do të përdorin falas pajisjet e dhëna nga Kontraktori.

ORGANIZIMI I PUNEVE

Kontraktorit i kërkohet të organizojë dhe të nivelojë punimet dhe mban përgjegjësi për sigurinë dhe suficencën e punimeve. Ai do t'i japë 48 orë përpara kërkesën e tij tek Inxhinieri për të bërë kontrollin

e duhur dhe do të sigurojë të gjitha instrumentat, shiritat etj si dhe ndihmesen tek Inxhinieri për kontrollin e duhur.

TABELA E PROJEKTIT

Në objekt do të vendosen dy tabela metalike me madhësi 2 x 2 m. Në çdo Tabele do të vendoset emri i Projektit, Punedhësit, Kontraktorit, Inxhinierit dhe të dhëna kryesore të Kontrates (vlera, afatet, etj) që duhet të tregohen.

DITARI I OBJEKTIT I KONTRAKTORIT

Kontraktori do të mbaje një ditar të punimeve në objekt ku do të shkruajë për eventet e rëndësishme, punimet e ekzekutuara, etj. Kontraktori duhet të paraqesë tek Inxhinieri në ditën e parë çdo jave ose në një periudhë me të gjatë që do të vendoset, një raport progresiv do të tregojë progresin e bërë në të gjitha sektoret e rëndësishme të punimeve, që nga raporti i fundit dhe progresin e përgjithshëm që nga fillimi i Kontrates. Raporti progresiv duhet të ketë lidhje me programin e punëve apo rishikimet e bëra që janë aprovuar herë pas here nga inxhinieri.

TAKIMET E PROGRESIT TË PUNIMEVE

Kontraktori duhet të marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga Inxhinieri në objektin e punës ose në zyrën e Inxhinierit për të diskutuar progresin e punëve dhe ose problemet që lidhen me to. Në vecanti, Inxhinieri do të bejë pershtatjet e duhura për takimet mujore në terren të thirrura nga Inxhinieri për të parë progresin e punëve.

Takimet në objekt do të përfshijnë normalisht inspektimin e shërbimit, së bashku me Kontraktorin, Inxhinierin dhe Punedhësin dhe Kontraktori do të bejë me të mirën e mundshme për të ndihmuar në këtë inspektim të perbashkët të punimeve.

NDIHMJA E SHPEJTE

Kontraktori do të sigurojë dhe mirembaje kantierin në vendin ku ndodhet duke u pajisur me të gjitha çantat e duhura të ndihmes së shpejtë në kushte të mira dhe të pastra në mënyrë që të jenë të gatshme në çdo kohë për punonjësit e tij, Inxhinierin dhe stafin e tij. Kontraktori do të ketë punonjësit përkatës të cilët duhet të jenë të instruktuar për mënyrën e ndihmes së shpejtë. Lista e telefonave, për ndihmën e shpejtë si doktore, ambulance apo ndonjë burim tjetër i jashtëm duhet të jetë i vendosur në një vend të dukshëm të kantierit.

STANDARDET

Te gjitha standratet ISO, EN ose ekuivalente Shqiptare dhe/ose standarte te tjera ekuivalente dhe manuale të dhëna ne kushtet e Kontrates do te jene pjese e Kontrates. Te gjitha referencat te dhëna në specifikimet teknike do te jene botime te fundit apo rishikime te tyre. Kontraktori duhet te aplikojë standartet, rregullat teknike dhe ligjet e përmenduar ne dokumentet e ofertes.

PRONESIA PRIVATE

Inxhinieri do te jete i informuar nga Kontraktori ne avancë 7 ditë mbi fillimin e aktiviteteve në prona private, nëse ka.

SPECIFIKIMET TEKNIKE – TE PERGJITHSHME

Të gjitha zerat ne Specifikimet dhe në Preventiv perfshijne të gjitha punimet duke perfshire, materialet, pajisjet, ndertimin dhe instalimin si dhe shërbime shtesë. Certifikatat për cilesine e te gjitha materialeve dhe paisjeve duhet te perfshihen.

PAJISJET E KANTIERIT

Për kompletimin e shërbimeve te dhëna nën këtë kontratë, Kontraktori duhet të:

- Siguroje aplikimet, veglat dhe materialet qe jane kerkuar per zbatimin e shërbimeve të specifikuara ne kontrate duke perfshire edhe transprotin e tyre dhe veprimet me to,
- Transportoje, montoje, mobiloje zyrat e kantierit, akomodimin, magazinën dhe cdo gje tjeter qe kerkohet per to.
- Te siguroje lidhjet e elektrikut, ujit, telefonit si dhe te cdo pajisje qe duhet per to ne vendin e shërbimit.
- Te siguroje rruget hyrese ne vendin e shërbimit sipas kërkesave,
- Te zbatoje punimet e tokes, perfshi edhe heqjen e bimesise sic kerkohet per te lehtesuar hyrjen ne kantier,
- Te gjeje vendet e duhura per pajisjet e kantierit.

Kostot per mirembajtjen dhe operimin e pajisjeve, duke perfshire rentimin dhe tarifa te tjera duhet te perfshihen në çmim.

Kontraktori duhet te mirembaje pajisjet ne objekt për te gjithë periudhen e shërbimit, duke përfshirë edhe nderprerjet te cilat nuk jane shkaktuar nga Punedhenesi dhe te furnizojë me energji, uje dhe material te tjera te kerkuara per zbatimin e shërbimit.

Kontraktori do te heqe te gjitha pajisjet dhe te risjellë ne gjendjen e mërpashme siperfaqet e përdorura dhe rruget ne kuptimin e menazhimit te tokes. Papastertite do te hiqen.

Kontraktori duhet te instaloje, mirëmbaje dhe te zgjidhe lidhjet e ujit dhe te elektrikut ne se do te perdore per nevojat e punimeve te tokes, tubat, kabllot e ketyre ndermarrjeve në baze të një marreveshje me keto ndermarrje për periudhen e shërbimit.

Shuaresit e Zjarrit: Shuaresit e Zjarrit duhet te jene ne objekt ne numrin dhe cilesine e dhene ne keto specifikime (shuares zjarri me ngarkese pluhuri nominale).

Shendeti dhe Siguria: Gjate punes ne objekt, te gjithë punonjesit duhet te jene te veshur me veshje sipas standarteve me veshje te mbrojtura per pune si helmata, kepuce pune, cizme, pantallona, kemishe, gota uji, etj. Ne te gjithë zonen e kantierit kontraktori duhet te vendose tabela me fraza te sigurise ne pune sipas procesit te punes. Perpara fillimit te nje procesi te ri te punes dhe cdo muaj, Inxhinieri duhet te lexoje rregullat teknike per sigurine nga libri i standarteve teknike.

Dokumentacioni Fotografik: Perpara, gjate dhe pas zbatimit te punimeve, foto me ngjyra duhet te behen per evidence te gjendjes ekzistuese te trasese se vendndodhjes se linjave respektive dhe impianteve te cilat mund te demtohen gjate ndertimit. Te gjitha demtimet duhet te fotografohen me qellim te mos kemi pretendime te pajustificuara nga pronaret. Fotot do te behen ne prezencë të Inxhinierit. Dokumentacioni i plote do të dorezohet tek Punëdhënësi.

BASHKËPUNIMI NË ZONË

Shërbimi do te behet ne zona te kufizuara. Sipermarresi duhet te kete vecanerisht kujdes ne:

- a) nevojën për te mirembajtur shërbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit për banoret dhe tregetaret që jane ne zone, gjate periudhes se ndertimit.
- b) prezencën e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna

E gjithë puna, do te behet ne nje menyre te tille, që te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë pajisjeve te mundeshme për ndonje Kontraktor tjetër dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo punonjesi që mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj për cdo objekt që ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjetër.

MBROJTJA E AMBIENTIT

Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të ndërmarre te gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera .

TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI I MATERIALEVE

Transporti i çdo materiali nga Sipermarresi do të bëhet me makina të përshtatshme të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar .Ndonje makine që nuk plotëson këto kërkesë ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet që sillen nga Sipermarresi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme për të mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyresit i Punimeve në çdo kohë.

1. GRUMBULLIMI I MBETJEVE

Kushtet teknike për mjetet e transportit

- a.** Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbeturinave.
- b.** Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenerët që përdoren në zonën qendrore.
- c.** Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e një cikli të plotë (ngritjen e kontenerit, shkarkimin dhe uljen e tij .
- d.** Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vetë dhe nuk duhet që puntorët të ngrënë kontenerin për ta varur atë në këtë sistem.
- e.** Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mirë, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jetë i aftë për të lëvizur me një shpejtësi deri në 80 km/h.
- f.** Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjisllacionit në fuqi.
- g.** Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjendje të mirë dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë.
- h.** Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.
- i.** Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit.
- j.** Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e makinave teknologjike dhe për faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.

k. Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situata nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

l. Makinat teknologjike duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjienik të mbetjeve.

m. Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë autoriteti kontraktor do të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

Personeli

b. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.

Transportimi i Mbetjeve

Shërbimi i Transportit të mbetjeve urbane konsiston në:

- Grumbullimin e mbetjeve drusore dhe atyre te ngurta në pikat e depozitimit të mbetjeve (kontanier).
- Transportin e mbeturinave në vend e depozitimit të tyre (ne vendin e caktuar nga Autoriteti).

KONTROLLI I CILËSISË

Kontraktori duhet të ketë në stafin e tij kyç personel të kualifikuar, të specializuar, dhe me eksperiencë, i cili do të jetë përgjegjës për kontrollin e cilësisë së të gjithë shërbimit. Kontrolli i cilësisë do të bëhet konform Kushteve teknike dhe standarteve përkatëse.